

VENDIM
Nr.632, datë 21.5.2008

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË
TË OBJEKTIT “ZYRA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE”, SARANDË, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.602, DATË 15.9.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore te Ministria e Drejtësisë të objektit “Zyra rajonale e sigurimeve shoqërore”, Sarandë, me sipërfaqe 140 (njëqind e dyzet) m², që ndodhet në ndërtesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, për rehabilitimin e kësaj gjykate.

2. Objekti i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të hiqet nga lista e inventarit, e miratuar me vendimin nr.620, datë 15.9.2006 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri

Sali Berisha